




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2907/12</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>16-08-2012</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **08.08.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4806-11, për z. *Xhelal Canziba* – ish Antar i Bordit të Kompanisë Regjinale “Eko Regjioni” Prizren, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky ish Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4806-11, për Zyrtarin e lartë, z. *Xhelal Canziba* – tani ish anëtar i Bordit të Kompanisë regjinale “Eko Regjioni” Prizren, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Zyrtarit të lartë, z. *Xhelal Canziba* i është bërë shkresa njoftuese, por e njejta pas një kohe na është kthyer, me një arsyetimin të shkruar në kovertë se; z. *Canziba* nuk ushtron me këtë funksion publik.

Ndërkohë kemi kërkuar zyrtarisht nga Kompania “Eko Regjioni” që të na e dërgoj listën e zyrtarëve të lartë që janë pjesë e Bordit të kësaj kompanie regjionale.

Me datën 06.08.2012, kemi marr shkresën përcjellese si dhe njoftimin zyrtar nga “Eko Regjioni” Prizren, se z.Xhelal Canziba, që nga maji i vitit 2011, nuk ushtron funksionin e anëtarit të Bordit të kësaj kompanie publike.

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera nxjerrim këtë:

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni